



SHLUIJ "UNIVERSITETI  
MARIN BARLETI"



**SHKOLLA E LARTË UNIVERSITARE PRIVATE  
"UNIVERSITETI MARIN BARLETI"  
FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE  
DEPARTAMENTI I QEVERISJES, POLITIKAVE DHE KOMUNIKIMIT**

**MASTER PROFESIONAL NË POLITIKA PUBLIKE DHE ADMINISTRIM**  
Rruga Sami Frashëri, Nr. 41, Tiranë; Tel: 04 225 26 21; Cel.: 0694004006 - 069 20 62 086  
E-mail: master@umb.edu.al - info@umb.edu.al; www.umb.edu.al

**PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS  
ADMINISTRIMI PUBLIK DHE INTEGRIMI EVROPIAN**

<b>TITULLI I LËNDËS:</b>	Administrimi publik dhe integrimi evropian
<b>LLOJI I LËNDËS:</b>	Formimi bazë
<b>TITULLARI:</b>	Dorian Jano, PhD
<b>KREDITET:</b>	4
<b>KOHA E REALIZIMIT:</b>	1 semester
<b>KONTAKTIMI I PEDAGOGUT:</b>	<a href="mailto:director.aipa@umb.edu.al">director.aipa@umb.edu.al</a>

**PËRSHKRIMI I LËNDËS**

Lënda do të fokusohet kryesisht tek politika ekzekutive e BE-së, duke vënë theksin tek impakti i Integritimit Evropian në strukturën dhe funksionimin e qeverisë dhe administratës jo vetëm të vendeve shtete-anëtare por edhe të vendeve potencialisht shtete-anëtare, rasti i Shqipërisë do të trajtohet si një rast studimi më vete. Një trajtim i veçantët do ti kushtohet kuadrit teorik të Europianizimit të ekzekutivit si dhe do të sillen shembuj nga studimet empirike në këtë fushë. Ky modul paraqet diskutimet shkencore mbi konceptin, procesin dhe mekanizmat specifike dhe kushtet e evropianizimit. Do të analizohen kapacitetet e brendshme europianizuese dhe fuqia transformuese e BE-së në Ballkanin Perëndimor. Kursi është i dizajnuar që të përfshijë ligjërata, diskutime, paraqitjen dhe ese të nxënësve.

**REZULTATET E TË NXËNËT**

Në Përfundimin e kësaj lënde studenti do të jetë në gjendje të njohë mënyrën e funksionit të institucioneve të BE-së, administrimin e politikave komunitare si dhe impaktin e integritimit Evropian në vendet shtete-anëtare dhe potencialisht shtete-anëtare. Përveç njohurive teorike studentët do të përfitojnë njohuri më të mira praktike duke aplikuar procedurat e vendimmarrjes dhe zbatimit të tyre në një simulim të mënyrës së funksionimit të BE-së.

**POLITIKA E FREKUENTIMIT**

Në përputhje me rregulloren e Universitetit "Marin Barleti" studenti duhet të jetë i pranishëm në 80% të orëve mësimore që do të zhvillohen në auditor.



## PËRGJEGJËSITË E STUDENTIT

- Të marrë pjesë në 80% të orëve mësimore.
- Të sigurojë literaturën e rekomanduar për lëndën.
- Të respektojë idetë e të tjerëve.
- Të marrë pjesë në mënyrë të efektshme në mësim.
- Të përmbushë detyrimet e lëndës në afatet e paracaktuara.
- Të jeni i pranishëm në mësim ditën që ka prezantimin e punimit.

## PLANI I ORËVE TEORIKE

Nr.	TEMA	Orë
1	<p>Hyrje: Procesi i zgjerimit të BE-së dhe qeverisja në shtetet anëtare të reja dhe vendet candidate.</p> <p>Institucionet e BE-së dhe marrëdhëniet midis tyre</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Ekzekutivi, Legjislative dhe Gjyqësori në BE.</li><li>• Ndarja e pushteteve.</li><li>• Roli dhe bashkë-koordinimi i institucioneve në BE</li></ul> <p>Impakti i Integritit European ne ekzekutivin e shteteve-anëtare</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Europeanizimi i qeverisë dhe administratës së shteteve-anëtare</li><li>• Mekanizmat dhe transformimet e mundshme</li></ul> <p>Transformimet post-komuniste në Europën Qëndrore dhe roli i procesit te integritit</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Impakti i procesit të integritit në institucionet dhe administratën publike</li></ul>	10
2	<p>Politika Ekzekutive e BE-së</p> <p>Leksioni do të fokusohet në karakterin e dyfishtë ekzekutiv të BE-së. Do të diskutohet rreth modelit teorik <i>principal-agent</i> për të shpjeguar rolin e komisionit në vendimmarrje.</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• 'Ekzekutivi i dyfishtë' i BE-së</li><li>• Modeli Principal-Agent</li></ul>	5
3	<p>Impakti i BE-së në sistemin politik kombëtar:</p> <p>Europeanizimi i ekzekutivit kombëtar tregon se integrimi European ka sjellë "një ndryshim në balancimin e pushteteve midis qeverive dhe administratave" (Wessels, Maurer, dhe Mittag 2003: xvi). Leksioni do të fokusohet në mënyrën se si marrëdhëniet e pushtetit brenda ekzekutiveve kombëtarë kanë ndryshuar, veçanërisht midis njësisë politike dhe asaj administrative të pushtetit ekzekutiv si dhe ndërmjet ministrive dhe. Ndërsa Këshilli fuqizon udhëheqjen politike të pushtetit ekzekutiv dhe të qeverisë në vendim-marrje, Komisioni fuqizon formacionet më të ulëta të nëpunësve civilë në ministritë e linjës.</p>	5
4	<p>Reformat administrative në Vendet Candidate: përmbushjen e kërkesave të anëtarësimit në BE.</p> <p>BE-ja i bën presion vendeve candidate për të reformuar administratat e tyre kombëtare gjatë procesit të anëtarësimit. Këto presione nuk janë uniforme, dhe përfshijë 'mekanizma europeanizimi' dhe 'mënyra qeverisjeje' të ndryshme. Reagimet kombëtare dhe rezultatet nuk konvergjojnë, kjo edhe për</p>	5



	shkak se nuk ka një model të vetëm të administratës kombëtare në vetë BE-në. Për më tepër, BE-ja nuk ofron një model preciz të përshtatjes të administratës. Ekzekutivi qendror i vendeve kandidatë mund të luajë një rol dominant. Anëtarësimi i mundshëm në BE-së është një forcë lëvizëse për reformat administrative, por vendet kandidatë kanë nevojë për një strategji afatmesme për tu zhvilluar në aktorë eficientë në procesin e politik-bërjes Europiane shumë-nivelëshe.	
<b>5</b>	<b>Rast Studimi: Shqipëria</b> Reforma administrative ka qenë një sfidë e veçantë për shumicën e vendeve post-komuniste, sidomos në rajonin e Ballkanit, ku shtetet e Ballkanit janë shkatërruar edhe nga mungesa e stabilitetit politik dhe trazira civile. Shqipëria është një rast i tillë. Administrata ka për bazë një staf të përzgjedhur me kritere më shumë politike sesa profesionale, e cila ka ndikuar pjesërisht në performancën e saj të dobët. Shqipëria është një rast i mirë studimi, për të vlerësuar nëse kushtëzimi i zgjerimit të BE ka luajtur një rol në përmirësimin e reformave.	<b>5</b>
<b>Totali</b>		<b>30</b>

### PLANI I ORËVE PRAKTIKE

<b>Nr.</b>	<b>Veprimtaria</b>	<b>Orë</b>
<b>1</b>	Diskutime të lira mbi zhvillimet e fundit të BE-së dhe ecurisë së procesit të integrimit të Ballkanit Perëndimor. Zhvillimet e Politikës së Zgjerimit. Kërkime në internet dhe familjarizimi me faqet zyrtare të BE-së	<b>5</b>
<b>2</b>	<b>Simulim: Modeli i Bashkimit Europian</b> Studenteve do tu caktohen roli që ata do të kenë dhe cilin institucion dhe shtet do të përfaqësojnë. Më pas do të caktohet çështja për të cilën ata do të përgatisin, negociojnë dhe në fund të mund të miratojnë një vendim duket simuluar procedurën e bashkë-vendimmarrjes në BE.	<b>5</b>
<b>Total</b>		<b>10</b>

### METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

Do të përdoren metoda e leksionit, diskutimit, debatit, studimi i rastit dhe puna në grupe. Leksionet do të japin kuadrin e përgjithshëm teorik të çështjeve si dhe do të ilustron me shembuj konkret nga studimet empirike. Gjatë leksioneve do të nxitet diskutimi dhe pjesëmarrja aktive e studentëve. Përveç përvetësimit teorik dhe akademik të lëndës, studentet do të kenë mundësinë të aplikojnë njohurit e fituara në simulimin e zhvilluar.

### VLERËSIMI

Studentët do të vlerësohen për angazhimin dhe performancën e tyre në klasë (20 pikë), vlerësimin në aplikimin konkret të njohurive në simulimin e organizuar (40 pikë) dhe në provimin përfundimtar me shkrim (40 pikë). Shumatorja e të gjithë këtyre vlerësimeve do të jetë nota përfundimtare.

Vlerësimi kryhet sipas sistemit të detajuar më poshtë:



Shkalla e pikëve	Nota numerike	Përshkrimi i notës	Nota me shkronja
96 – 100	10	Shkëlqyeshëm	A+
86 - 95	9	Shumë mire	A
76 - 85	8	Mirë	B+
66 - 75	7	Kënaqshëm	B
56 – 65	6	Mjaftueshëm	C
50 – 55	5	Kalueshëm	D
≤49	4	Mbetës	FX
	3, 2, 1	Mbetës	F

## LITERATURA E REKOMANDUAR

### Literatura bazë

- Cikël Leksionesh

### Literatura ndihmëse

- Dimitrova, Antoaneta. L. (2005) 'Europeanisation and administrative reform in Central and Eastern Europe' në Schimmelfennig, Frank dhe Sedelmeier, Ulrich (Eds.), *The Europeanisation of Eastern Europe* fq. 71-91. (Ithaca: Cornell University Press).
- Elbasani, Arolda (2008) 'EU Enlargement and State Institutions after Communism – Reforming Public Administration in Albania', *L'Europe en formation*, 349-350: 119 – 134.
- Goetz, Klaus H. dhe Meyer-Sahling, Jan-Hinrik (2008) 'The Europeanisation of national political systems: Parliaments and executives', *Living Reviews in European Governance*, 3(2). <http://www.livingreviews.org/lreg-2008-2>
- Goetz, Klaus H. , (2001) 'Making sense of post-communist central administration: modernization, Europeanization or Latinization?', *Journal of European Public Policy*, 8(6): 1032 – 1051.
- Hafner, Danica Fink , (1999) 'Dilemmas in managing the expanding EU: the EU and applicant states' points of view', *Journal of European Public Policy*, 6(5): 783 – 801.
- Hix, Simon dhe Hoyland, Bjorn (2011) *The Political System of the European Union*, (London: Macmillan).
- Kassim, Hussein (200) 'Conclusion. The National Co-ordination of EU Policy: Confronting the Challenge', në Hussein Kassim, Guy Peters, and Vincent Wright (eds.) *The National Co-ordination of EU Policy: The Domestic Level* (Oxford: Oxford University Press)
- Lippert, Barbara, Umbach, Gaby dhe Wessels, Wolfgang, (2001) 'Europeanization of CEE executives: EU membership negotiations as a shaping power', *Journal of European Public Policy*, 8(6): 980 – 1012.